



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 18.02.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Sadri Ferati, kryesues i Komisionit, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izma, Alma Lama, Shqipe Pantina dhe Pal Lekaj, në mbledhje mori pjesë edhe deputetja Doruntine Maloku.

Mungoi: Zenun Pajaziti, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë: Bordi i RTK-së dhe menaxhmenti, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe Sindikata e RTK-së.

Mbledhjen e kryesoi: Sadri Ferati, Zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takimi i Komisionit me Bordin dhe menaxhmentin e RTK-së.**
- 3. Të ndryshme.**

Mbledhjen e hapi,

Sadri Ferati – e njoftoi Bordin se komisioni në planin e punës ka paraparë takime me bordet dhe agjencionet të cilat i mbikëqyr në kuadër të fushëveprimtarisë së komisionit dhe mbi këtë bazë është thirr edhe ky takim që të bashkëbisedohet me bordin e RTK-së. Ai, kërkoi nga kryetari i bordit të RTK-së, që të njoftoj komisionin për situatën në RTK, për pikat që komisioni mund të ndihmojë RTK-në dhe si e sheh RTK-ja bashkëpunimin me komisionin, ndërsa për çështje të tjera të detajizuara do të diskutohet në takimin kur RTK-ja do të raportojë me raportin vjetor, në muajin prill, konform ligjit në fuqi.

Xhevahire Izma – gjithashtu e njoftoi Bordin e RTK-së, se takimi është thirr në vazhden e takimeve që komisioni ka me bordet dhe agjencionet të cilat bien në fushëveprimtarinë e Komisionit, duke theksuar se takimi me Bordin e RTK-së është takimi i dytë i komisionit, pas takimit me anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media, në këtë drejtim takimi është thirr për tu njoftuar me sfidat e RTK-së karshi procesit të digjitalizimit, në të cilin proces edhe zbatimi i ligjit do të jetë sfida për transmetuesin publik.

Shqipe Pantina – tha se takimin e ka kuptuar si takim në të cilin RTK-ja duhet të raportojë në Kuvend, në mënyrë periodike, duke e cituar nenin 30 pika 9, të Ligjit për RTK-në, lidhur me këtë ajo kërkoi një raportim periodik nga Bordi i RTK-së.

Sadri Ferati - duke iu drejtuar deputetes, tha se takimi është takim njoftues, sepse tani ka më pak se dy muaj që kur është konsituuar komisioni dhe ne presim raportimin periodik në kuadër të obligimit ligjor.

Alma Lama - kërkoi që takimi të zhvillohet vetëm me bordin e RTK-së, si institucion të cilin e emëron Kuvendi dhe i cili është i obliguar të raportojë para Kuvendit si themelues, ndërsa menaxhmentin e zgjedh Bordi të cilit edhe i raporton.

Ismet Bexheti - njoftoi komisionin për zhvillimet dhe punën njëvjeçare të RTK-së, ai tha se kjo periudhë ka qenë një periudhë e ndryshimeve të mëdha, në vitin e kaluar është zgjeruar hapësira programore në katër kanale televizive duke përfshirë edhe kanalin satelitor, në kuadër të ndryshimeve janë edhe shtimi i lajmeve televizive njëzet e katër, sa i përket ndryshimeve në teknologjinë e RTK-së ka kaluar nga një sistem shume i vjetërsuar në sistem digjital që ndikon në lehtësimin e punës se të gjithë stafit realizues të RTK-së, ka mbuluar edhe fushatën zgjedhore. RTK në mungesë të hapësirave dhe për një funksionim me të mirë ka renovuar garazhet duke shndërruar për studio televizive, për më tepër RTK-ja në fund të vitit të kaluar, ka marrë një urdhëresë me shkrim nga AKP-ja sipas së cilës urdhërohet RTK-ja të paguaj qiranë për objektin i cili është pronë e ish-Radiotelevizionit, të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar edhe në shtimin e numrit të punëtorëve, vlen të theksohet se krejt këto janë arritur me një buxhet të njëjtë të viteve paraprake.

Alma Lama – parashtrroi këto pyetje bordit të RTK-së, si vijon:

- Sa është numri i punëtorëve përfshirë edhe punëtorët me kontratë mbi vepër si dhe përbërja etnike e tyre përfshirë këtu edhe kanalin e dytë të RTK-së?
- Lidhur me urdhëresën e AKP-së për qira, a ka filluar RTK-ja të paguajë qiranë, a ka mungesë të pjesëmarrjes së grave në programet informative të RTK-së dhe a ka shifra për pjesëmarrjen e gruas në programe informative?
- Mbi çfarë baze transmetohen shumë nga programet për të cilat ka vërejtje të jashtëzakonshme në publik përfshirë edhe programet dokumentare të cilat emetohen pa kurrfarë kriteri vetëm për promovimin e personave të cilët nuk paraqesin vlerë të madhe për shoqërinë, gjithashtu edhe për disa nga serialet të cilat promovojnë agjenda antikombëtare?
- Deri ku ka arritur bordi rreth gjetjes së alternativave për financim të RTK-së, konform ligjit, bordi duhet të gjejë zgjidhjen?
- Si është e përcaktuar me Statut të RTK-së, publikimi i raportit vjetor?

Shqipe Pantina- pyeti bordin e RTK-së rreth transparencës për punën e tyre, sipas nenit 38?

- Pse, nuk janë të publikuara në ueb-faqe raportet vjetore për punën e RTK-së për vitin 2011, 2012, 2013, konform nenit 38 të ligjit për RTK-në, ajo kërkoi informatë se a ka RTK-ja raport mbi debatin publik, sipas nenit 38.3, lidhur me përmbajtjen e raportit vjetor si dhe mendimet e bordit për raportin e debatit për qëllimet orientuese?
- Meqë në ueb-faqe nuk janë as vendimet e bordit të RTK-së, ajo kërkoi të informohet për të gjitha vendimet e RTK-së, si dhe transkriptet e mbledhjeve nga të cilat janë nxjerr ato vendime?
- Pse RTK-ja nuk e ka dorëzuar propozim buxhetin për vitin 2015, sipas nenit 21. pika 6.1?
- Pse RTK-ja ka krijuar borxhe, në vlerë pesë milion, kujt i ka borxh, si ka lejuar bordi që të miratojë një buxhet i cili tejkalon shpenzimet nga të hyrat?
- Sa është kostoja e hapjes së kanaleve dy, tre, katër, të RTK-së, dhe

- Si e ka adresuar bordi çështjen e mostransparencës dhe nepotizmit me rastin e rekrutimit të punëtorëve të RTK-së, pasi që kjo është përmend si shqetësim edhe në Raportin e Progresit për Sfidat në Kosovë?
- Sa anëtar ka grupi këshillues, kush janë dhe si janë zgjedhur ata, çfarë raporte kanë hartuar dhe a mund të kemi raportin e fundit?
- Sipas nenit 12, RTK-ja duhet që së paku 15 %, por jo më shumë se 20 %, të programit në transmetimet radiotelevizive të sigurojë nga producentët e pavarur vendor, lidhur me këtë: Cilat janë procedurat sipas së cilave është bërë përzgjedhja e këtyre emisioneve, programeve, në çfarë përbërje ka qenë paneli përzgjedhës, sa ka qenë shuma që RTK-ja ka paguar për ato programe, veçanërisht për emisionin –KOMITETI?
- Pse, RTK-ja paguan qira për pajisje teknike dhe sa janë shpenzimet për huazimin e pajisjeve?
- Pse RTK-ja huazon, blen lajme nga mediumet tjera?
- Sa janë demet e shkaktuara nga djegia e arkivit të RTK-së në vitin 2012?

Kujtim Paçaku - duke iu drejtuar kryetarit të bordit, tha se gjatë raportimit nuk ka dëgjuar asgjë për programet e komuniteteve pakicë ai duke cituar nenit 8 pika 3, të Ligjit për RTK-në, sipas së cilit nën kanali 1 dhe 2 i RTK-së janë të detyruara të ofrojnë 15% të skemës programore për gjuhët e komuniteteve tjera në Kosovë, si dhe sipas pikës 6 të të njëjtit nën RTK-ja mund të zgjerojë rrjetin e tij transmetues edhe me kanale në gjuhët e komuniteteve tjera lidhur me këtë pyeti:

A do të mendohet se RTK-ja, në rrjetin e kanalit të dytë të përfshijë edhe emisione, gjegjësisht redaksitë me programet në gjuhët e pakicave të tjera, pakicës turke, boshnjake, këtu nuk po e përmendi pakicën romë përderisa të kemi edhe një staf profesional, si dhe të mendohet për shpërndarjen e drejtë të mjeteve financiare të cilat dedikohen edhe për pakicat tjera?

Ismet Bexheti – iu përgjigj pyetjeve të parashtruara:

Numri i punëtorëve në RTK është 698 punëtorë të rregullt, 234 me kontrata me punë dhe detyra specifike, kontrata mbi vepër, përfshirë këtu edhe punëtorë të komuniteteve të tjera me përqindje prej 15 % sepse jemi transmetues që transmetojmë programe në gjashtë gjuhë, sa i përket skemës programore në gjuhët e komuniteteve të tjerë RTK-ja e tejkalon shifrën prej 15%, për pjesëmarrjen e gruas në emisionet informative kjo më tepër i takon politikës redaktoriale, editoriale.

Në pyetjen për transparencën e RTK-së, këtë vit auditori i përgjithshëm duhet të përfundon raportin e performancës së RTK-së, sa i përket publikimit të raporteve vjetore ato nuk janë publikuar për arsye se nuk janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës, raportet nuk publikohen para se të miratohen në Kuvend dhe raportimi i RTK-së në komisionet përkatëse e përmbush obligimin e RTK-së për raportim.

Sa i përket financimit të RTK-së, bordi i RTK-së ka adresuar në Kuvend propozimet dhe presin një vendim të Kuvendit lidhur me këtë.

Sadri Ferati - në përmbyllje të mbledhjes kërkoi nga bordi i RTK-së, në mungesë të marrjes së përgjigjeve për pyetjet e parashtruara nga ana e deputetëve, përgjigjet t'i dërgohen me shkrim komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora: 13:45.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti